



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO  
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS  
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

**Dhjetor / 05**  
**Nr. 52**

# **BULETINI MUJOR STATISTIKOR**

**DEPARTAMENTI  
PËR KËRKIME  
DHE STATISTIKË**

Prishtinë 2005



---

BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO  
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TË KOSOVËS  
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

## **BULETINI MUJOR STATISTIKOR**

**BOTUES** Autoritet Bankar dhe i Pagesave të Kosovës  
Departamenti për Kërkimeve dhe Statistikë  
Garibaldi 33, Prishtinë  
Tel.: ++381 38 222 243  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e Internetit** [www.bpk-kos.org](http://www.bpk-kos.org)  
**Adresa elektronike** [research@bpk-kos.org](mailto:research@bpk-kos.org)

**KRYEREDAKTOR** Gani GËRGURI

**KËSHILLI REDAKTUES** Jeton BAJRAMAJ  
Teuta ISMAJLI  
Valbona MORINA  
Mimoza MUSTAFA  
Valentin TOÇI  
Semra TYRBEDARI

**REDAKTORË** Mentor GECI  
Bedri ZYMERI

**REDAKTOR TEKNIK** Nazlije HOTI

**BASHKËPUNËTOR** Rudi ACX

**Shtypur në:** "BLENDI" Prishtinë

Përdoruesit e të dhënave nga ky botim janë të lutur që të citojnë burimin e tyre.

Çdo korrigjim që mund të kërkohet do të bëhet në versionin në elektronik ne faqen e internetit.

Shtypur në 100 kopje.

Ky botim përfshin të dhëna të disponueshme deri në datën: 02 Shkurt 2006.

## SHKURTESAT:

BPK	Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës;
IÇK	Indeksi i Çmimit të Konsumit;
KD	Korpotara Depozituese;
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive Regjionale and Kombëtare 1995;
EUR	Valuta Euro;
KF	Korporatat Financiare;
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto;
TKDB	Të Ardhurat Kombëtare të Disponueshme Bruto;
KS	Kompanite e Sigurimeve;
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar;
RNK	Raporti mbi Normat e Kamatës;
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës;
AKM	Ajencia Kosovare e Mirëbesimit;
DSMF	Doracaku mbi Statistikat Monetare dhe Financiare;
MHN	Mjetet e Huaja Neto;
OJSHEF	Organizatat Jofitimprurëse që i Shërbejnë Ekonomive Familjare;
KTD	Korporata të Tjera Depozituese;
KTF	Korporata të Tjera Financiare;
NTF	Ndërmjetësues të Tjerë Financiar;
FP	Fondet Pensionale;
RBS	Raporti Bankar Statistikor;
SNA	Sistemi i Llogarive Kombëtare i Kombeve të Bashkuara 1993;
TPL	Detyrimet Ndaj Palës së Tretë;
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.;
SRTN	Sistemi i Raportimit të Transakcioneve Ndërkombëtare.

## SIMBOLET KONVENCIONALE:

" — "	dukuria nuk ekziston;
" . "	dukuria ekziston, të dhënat nuk janë të disponueshme;
" ... "	zero ose afër zeros;
(e)	e vlerësuar;
(p)	e përkohshme.

## VËREJTJE:

Përshkak të rumbullaksimeve, shumat mund të mos jenë plotësisht të sakta me pjesët e tyre.

## INFORMATË:

Për një përshkrim më të detajizuar të terminologjisë që përdoret në Buletinin Mujor Statistikor, ju lutemi që t'i referoheni shënimeve sqaruese që gjenden në fund të buletinit.



## PËRMBAJTJA

---

<b>VLERËSIMI I TREMUJORIT</b> -----	<b>7</b>
<b>1. TREGUES TË ZGJEDHUR MAKROEKONOMIK</b> -----	<b>15</b>
<b>2. ZHVILLIMET AKTUALE (grafikët)</b> -----	<b>17</b>
2.1. Sektori financiar -----	19
2.2. Sektori fiskal -----	24
2.3. Sektori real -----	25
2.4. Sektori i jashtëm -----	25
<b>3. TABELA STATISTIKORE</b> -----	<b>27</b>
3.1. Sektori financiar -----	29
3.2. Sektori fiskal -----	48
3.3. Sektori real -----	49
3.4. Sektori i jashtëm -----	50
<b>SHËNIME SQARUESE</b> -----	<b>55</b>





## EDITORIAL

Autoriteti i Bankave dhe Pagesave të Kosovës po vazhdon me përpjekjet për t'i ofruar publikut për çdo muaj informacion në lidhje me zhvillimet kryesore në sektorin financiar dhe sektorët e tjerë. Me qëllim që të kemi një pamje të konsoliduar të zhvillimeve financiare në Kosovë, përparim i dukshëm është bërë në përmirësimin e statistikave në sektorin financiar, e posaçërisht në sektorët që kanë të bëjnë me bankat dhe ndërmarrje të tjera financiare. Gjithashtu, po bëhet punë e vazhdueshme në përpilimin e Statistikave të Bilancit të Pagesave (fillimisht në baza vjetore) që do të rrisnin mbulimet statistikore dhe do të ngushtonin boshllëkun e informacionit ekzistues në lidhje me zhvillimet ekonomike në Kosovë.

Ky numër i buletinit, sikur edhe numrat e mëparshëm, vlerëson zhvillimet kryesore në bazë tre mujore. Një theks i veçantë i është kushtuar zhvillimeve në sektorin financiar, ndërkaq vëmendje më e vogël i është kushtuar edhe sektorëve tjerë. Megjithatë, mungesa e të dhënave tremujore mbi sektorin real dhe sektorin e jashtëm është pengesa kryesore në krijimin e vlerësimeve më të hollësishme.

Meqenëse Kosova ka për valutë euron dhe partnerët e saj kryesor tregtarë janë anëtarë të Bashkimit Evropian (BE), ne i kemi kushtuar ca vëmendje zhvillimeve kryesore në euro zonë. Pjesa tjetër e vlerësimeve përmban analizë tremujore të sektorit financiar nga perspektiva e pasqyrave financiare, pasuar nga zhvillimet në sektorin e bankave komerciale. Gjithashtu ka disa përshkrime mbi sektorin fiskal, real dhe atë të jashtëm..

## EURO ZONA

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është përmirësuar në gjysmën e dytë të vitit 2005. Sipas vlerësimeve të Eurostat-it, PBB krahasuar me tremujorin paraprak ka treguar një rritje prej 0.6% në tremujorin e tretë të vitit 2005. Përderisa në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2004, PBB është rritur për 1.6 %. Konsumi privat është rritur për 0.3% dhe si i tillë ka kontribuar me 0.2 pika të përqindjes (pp) në rritjen e PBB-së. Konsumi qeveritar është rritur për 0.6% dhe ka kontribuar në ndryshimin e PBB-së me 0.1 pp. Me një rritje tremujore prej 1.6%, formacioni i kapitali fiks bruto kontribuoi në rritjen e PBB-së me 0.3%. Që nga tetori 2005, bilanci i vlerësuar tregtar në euro zonë ka treguar deficit prej 1.2 miliardë euro dhe llogaria rrjedhëse një deficit prej 9 miliardë euro. Deficiti i llogarisë rrjedhëse ka rezultuar nga të deficitit i të hyrave (7.4 miliardë euro) dhe transferove rrjedhëse (4.4 bilion euro), balancuar lehtë me një tepriçë në shërbime prej 2.6 bilion euro.

Gjatë T4 2005 inflacioni vjetor sipas indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICP) në euro zonë është zvogëluar vazhdimisht duke arritur në 2.2% nga 2.6% i T3 2005. Shkallët më të larta të inflacionit janë regjistruar nga patundshmëritë (5.1%), transporti (4.5%), alkooli dhe cigarja (2.7%), përderisa është treguar rënie në komunikim (-2.8%). Shkalla e inflacionit bazik (duke përjashtuar energjinë dhe ushqimin e papërpunuar) ishte 1.4% nga fundi i T4 2005 që korrespondon me një ulje të lehtë nga 1.5% të T3 2005. Tregjet e mallrave në Q4 2005 kanë vazhduar të identifikohen me çmime të larta të derivateve të naftës, por jo aq të larta si në fund të gushtit dhe në fillim të shtatorit të vitit 2005. Çmimi i "Brent Crude" ishte 6.22 dollar/fuqi, vetëm 8% nën pikën më të lartë të përmendur, por megjithatë 56 % më lartë se në fillim të vitit 2005.


Euro ka devaluuar kundër dollarit amerikan përgjatë T4 2005, duke u zvogëluar në 1.19 \$ nga mesatarja 1.22 \$ në T3 të vitit 2005. Norma nominale efektive e këmbimit të euros krahasuar me valutat e 23 partnerëve kryesorë tregtarë ishte për 2% më e ulët se sa mesatarja përgjatë vitit 2005.

Që nga 6 dhjetori 2005, Banka Qendrore Evropiane ka vendosur të rris normat bazike të interesit për 25 pika bazike (bp), kështu që norma minimale ofertuese është rritur nga 2% në 2.25 %. Në tetor 2005, normat e interesit për depozitat afatgjata të ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare, është rritur për 10 bp (nga 2.06% në 2.16%) dhe 39 bp (nga 2.98% në 3.37%), përkatësisht. Në të kundërtën, normat afatgjate të kredive të korporatave jofinanciare janë ulur për 9 bp (në 3.78% nga 3.87%) përderisa normat e interesit për kredi shtëpiake kanë mbetur te pandryshuar. Në T4 2004 rendimenti i bondit qeveritar 10-vjeçar qëndroi në 3.42%, mesatarisht, përderisa rendimenti i bondit 5 vjeçar ishte 3.01%, duke treguar rritje nga tremujori paraprak.

## SEKTORI FINANCIAR

Me një shumë prej 662.5 milion euro në fund të T4 2005, Mjetet e Huaja Neto (MHN) të korporatave financiare kanë treguar një rritje prej 3.6% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar. Përderisa krahasuar me tremujorin paraprak MHN-të janë zvogëluar për 0.3%. Duke arritur shumën 749.8 milion euro në Q4 2005, kërkesat ndaj jo-rezidentëve kanë pësuar një rritje të pavërejtur prej 0.01%. Andaj, ndryshimi tremujor i MHN-ve kryesisht ishte rezultat i rritjes së detyrimeve ndaj jo rezidentëve (2.5%)

Grafiku 1 tregon se pjesëmarrja e MHN-ve të BPK-së dhe KTD-ve (Korporatat e tjera depozituese) në MHN-të e tërësishme të korporatave financiare, ka ndryshuar shumë pak.. Gjithashtu, kontributi negativ i MHN të KTF-ve (Korporatat tjera financiare) rritet gjer deri në një masë të caktuar meqë detyrimet ndaj jo-rezidentëve janë rritur për 2.7%.




Depozitat me një pjesëmarrje prej 56.4%, paraqesin instrumentin kryesor të kërkesave ndaj jo-rezidentëve. Krahasuar me T3 2005, kjo pjesëmarrje është rritur për 6.4 pp, ndërkaq është zvogëluar për 13.3 pp krahasuar me T4 2004. Në anën tjetër, pjesëmarrja e letrave me vlerë (të investuara jashtë) pësuan një ngritje prej 3.5 pp në baza tremujore dhe rritje vjetore prej 13.5 pp.

Në fund të vitit 2005, kreditë nga jo-rezidentët arritën shumën 65.8 milion euro nga 61.7 milion euro dhe 34.1 milion euro në T3 2005 përkatësisht dhe T4 2004. Pjesëmarrja e tyre në detyrimet ndaj jo-rezidentëve është 75.4% apo 2.9 pp më lartë se në T3 2005. Depozitat, si komponent i dytë i detyrimeve ndaj jo-rezidentëve ka zbritur

për 8.3% duke arritur shumën 21.5 milion euro në T4 2005.


Kërkesat e brendshme të korporatave financiare (351.9 milion euro) në fund të vitit 2005 kanë përjetuar rritjen më të lartë përgjatë tërë vitit. Për shkak të rritjes së konsiderueshme të kërkesave në sektorin real, kërkesat e brendshme ishin për 24.9% dhe 71.1% më të larta, në relacion me T3 2005, respektivisht T4 2004. Derisa në perspektivë vjetore detyrimet ndaj sektorit fiskal në përgjithësi paraqesin një pamje të qëndrueshme, kërkesat ndaj sektorit real janë rritur për 37.0%.



Paraja e gjerë (M2) arriti 1.116 milion euro, duke u rritur për 0.9 % dhe 3.7% krahasuar me T3 2005 përkatësisht T4 2004. Përgjatë vitit 2005 rritja e M2 ishte kryesisht e mbështetur nga kontributi e depozitave të tjerë (+9.3%), përderisa M1 tregoi rënie të vazhdueshme (duke kontribuar me -5.7%) për shkak të rënies së valutës jashtë korporatave depozituese (shih grafikun 3).

Depozitat e tjerë (rreth 60% të shumës së përgjithshme) janë rritur rreth 25.4% në krahasim me T4 2004. Në të njëjtën kohë, valuta jashtë korporatave depozituese ka zbritur për 26.7% gjatë T4 2004, dhe si rezultat ka kontribuar negativisht (-15.2%) ndaj agregatit monetar M1. Kjo rënie e valutës pjesërisht u balancua nga kontributi pozitiv i depozitave të transferueshme (+6.2%) duke rezultuar në një rënie prej 9.0% të M1 në T4 2005 (në baza vjetore).

Grafiku 3. Paraja M2, M1 dhe valutat jashtë korporatave depozituese



### Zhvillimet në sektorin bankar

Gjatë T4 2005, bankat komerciale zgjeruan rrjetin e tyre të punës me 6 njësi të reja bankare duke ngritur kështu numrin e përgjithshëm të njësive në 224, gjë që rezultoi në rritjen e stafit punues. Numri i tërësishëm i të punësuarve në fund të 2005 arriti 2341 (nga 2285 në T3).


Sektori financiar në Kosovë vazhdon të dominohet nga sektori bankar. Në veçanti, në fund të tremujorit të fundit të vitit 2005 mjetet e sektorit bankar kanë arritur vlerën prej 983.5 milion euro, që korrespondon me një rritje prej 5.8 % krahasuar me T3 apo 21.0% krahasuar me T4 2004.

Përbërja e mjeteve të bankave komerciale (grafiku 4) ka pësuar ndryshime të vogla gjatë T4 2005. Duke përbërë 13.5 % të mjeteve të tërësishme, paratë e gatshme dhe bilanci me BPK-në janë rritur për 10.6 % krahasuar me Q3 2005, duke arritur kështu vlerën prej 132.9 milion euro në fund të vitit 2005. Ngjashëm, bilanci me bankat e tjera ka arritur 221.9 milion euro (nga të cilat 86.9% me banka jo-rezidente), që paraqet një ngritje prej 18.6 % krahasuar me Q3 2005 (duke përbërë 22.6% të mjeteve të tërësishme). Në të kundërtën, bankat komerciale kanë zvogëluar investimet e tyre në letrat me vlerë për 24.2%, të cilat investime në fund të vitit 2005 kanë arritur shumën prej 82.9 milion euro. Përcjellë nga ky zvogëlim, në fund të vitit 2005 investimet në letra me vlerë përbëjnë 8.4% të shumës totale të mjeteve, nga 11.8 % në T3 2005.

Rritja e aktivitetit huadhënës ka ndikuar më së shumti në reduktimin e investimeve në letra me vlerë. Si rrjedhojë, në fund të vitit 2005, kreditë e dhëna për ekonomi shtëpiake janë rritur për 7.7%,

arritur në 513.8 milion euro. Si rezultat, kreditë kanë gjeneruar kontributin më të lartë (4.0%) në rritjen e mjeteve totale.

Grafiku 4. Struktura e bilancit të gjendjes së bankave komerciale - Mjetet




Pjesa më e madhe e kredive (75.5%) është drejtuar ndaj korporatave jo-financiare të cilat në fund të vitit 2005 kanë arritur shumën prej 387.8 milion euro, duke paraqitur një rritje prej 9.5% krahasuar me T3 2005. Në anën tjetër, aktiviteti huadhënës ndaj ekonomisë shtëpiake është rritur për 2.5 % gjatë T4 2005 krahasuar me 10.0% në T3 2005 dhe ka arritur shumën prej 125.9 milion euro.

Sa i përket strukturës së maturitetit të kredive, në T4 2005 kreditë me afat kthimi deri në 1 vit përbëjnë 26.7% të të gjitha kredive (zbritur nga 27.3% në T3 2005 – grafiku 5). Sa i përket volumit të tyre ato janë rritur për 5.6 % krahasuar me T3 2005, apo 7.9% krahasuar me fundvitin 2004. Në kontrast me këtë, kreditë e dhëna me maturitet më të gjatë se 1 vit e deri në 2 vite përbëjnë 28.5% të kredive të tërësishme apo 146.3 milion euro (një rritje prej 7.8% krahasuar me T3 2005). Kreditë me afat kthimi mbi dy vite, që arrijnë shumën prej 230.1 milion euro janë rritur për 9.0%. Në T4 2005 pjesëmarrja e tyre ka arritur 44.8 % të kredive totale të sektorit bankar.

Pjesa më e madhe e kredive është drejtuar ndaj sektorit tregtar me një rritje prej 7.3% duke përbërë kështu 51.8 % të shumës së përgjithshme. Një rritje tjetër është regjistruar në kreditë për industri (35.0%) të cilat në fund të vitit 2005 kanë paraqitur 10.0% të të gjitha kredive. Kreditë për bujqësi përfshijnë 2.6% të kredive në tërësi dhe në fund të vitit 2005 arritën vlerën prej 11.9 milion euro.


Me shumën prej 835.9 milion euro në T4 2005, depozitat totale në bankat komerciale në Kosovë kanë ruajtur pjesëmarrjen e njëjtë (85.0%) ndaj detyrimeve të përgjithshme, krahasuar me T3 2005.




Depozitat e tjera (me afat dhe ato të kursimeve), si përbërësitë më të mëdhenj të depozitave (62.8%) janë rritur për 10.4% krahasuar me tremujorin paraprak. Kjo është pasuar nga një zvogëlim i depozitave të transferueshme (-1.7%), duke zvogëluar pjesëmarrjen e tyre ndaj depozitave totale në 35.4% (-2.7pp).

Duke përbërë 53.8% të depozitave të tërësishëm, depozitat ndaj ekonomive familjare janë rritur për 7.3% dhe në fund të viti 2005 arritën shumën prej 466.2 milion euro. Depozitat e korporatave jo-financiare pësuan rënie sa i përket pjesëmarrjes së tyre në tërësinë e depozitave, nga 36.7% në T3 në 35.6% në T4 2005. Depozitat e korporatave financiare përbëjnë 6.7% të depozitave totale (nga 6.5% në T3 2005); përdërisa depozitat e sektorit qeveritar kanë arritur një përqindje modeste prej 0.3% të depozitave totale në sektorin bankar në Kosovë. Pjesa e mbetur e tërësisë së depozitave mbetet për depozitat e jo rezidentëve dhe OJSHEF-ve.

Gjatë T4 2005 normat e interesit janë radhitur mes 2.10% dhe 4.57% për depozitat e pranuar dhe mes 12.17% dhe 15.52% për kreditë e dhëna. Në krahasim me T4 2005, normat e interesit në depozita janë rritur për 0.2 pp mesatarisht, përdërisa normat e interesit në kredi ka rënë për 0.3 pp. Megjithatë, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të dukshëm krahasuar me T3 2005.



Nga grafiku 7 shihet se gjatë T4 2005 likuiditeti i bankave komerciale mbetet i qëndrueshëm. Në veçanti, proporcioni i kredive ndaj depozitave në fund të vitit 2005 arriti në 61.5% prej 60.3% sa ishte në T3 2005. Ngritja e këtij raporti është atribuar kryesisht nga një ngritje më e shpejtë e kredive (7.7%) shoqëruar nga një ngritje modeste e depozitave (5.8%).




Në fund të T4 2005, ndërmjetësuesit e tjerë financiarë menaxhuan rreth 27100 kredi, me një shumë të përgjithshme prej 51.7 milion euro (duke përbërë 9.1% të kredive të KF). Krahasuar me T4 2004, numri i kredive dhe shuma janë rritur për 21.7%, përkatësisht 29.7%.


Në raport me T3 2005 dhe T4 2004, mjetet e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) në T4 2005 janë rritur për 14.1%, respektivisht 73.1%. Shuma e tyre qëndroi në 143.7 milion euro, prej të cilave 95% janë investuar jashtë vendit të menaxhuara nga institucionet e jashtme financiare: ABN AMRO dhe Vanguard

## SEKTORI FISKAL


Në nëntor të vitit 2005 (në baza kumulative) të hyrat qeveritare arritën shumë prej 588.7 milion euro me shpenzime prej 572.8 milion euro. Kjo tregon një suficit prej 15.9 milion euro. Megjithatë, ka ngjeshje në suficit krahasuar me korrikun kur ishte 40.9 milion euro.



Përbërësit e të hyrave kanë treguar të njëjtën pjesëmarrje si vitin e kaluar (grafiku 10). Përbërësi kryesor mbeten të hyrat tatimore, që përbëjnë 87.3% të të hyrave. Tatimet kufitare arritën shumë prej 399.6 milion euro, duke përbërë kështu 77.7% të të gjitha të hyrave tatimore. Pjesa tjetër e të hyrave tatimore është realizuar nga tatimet e brendshme. Kategoria e dytë, të hyrat jo-tatimore në fund të nëntorit të vitit 2005 arritën shumë prej 41.5 milion euro (7.0% nga të hyrat e përgjithshme). Dhe së fundi të hyrat vetjake të komunave, grantet e donatorëve dhe interesi përbëjnë 5.6% të të hyrave.




Në baza vjetore, shpenzimet janë rritur për "pagat dhe të ngjashme" (12.7%) dhe "subvencionet dhe transfertat" (10.4%). Pagat dhe të ngjashme në nëntor të vitit 2005 kanë përbërë 30.5% të shpenzimeve (5.2 pp më shumë se nëntorin e vitit 2004). Kjo është balancuar nga zvogëlimi i shpenzimeve për "mallra dhe shërbime" (27.7%) dhe shpenzime kapitale (21.2%). "Mallrat dhe shërbimet" kanë zvogëluar gjithashtu pjesëmarrjen e tyre ndaj totalit të shpenzimeve, nga 26.0% të vitit paraprak në 20.1% në nëntor 2005.



## Çmimet

Indeksi i Çmimeve të Konsumit në dhjetor 2005 ka ndryshuar për 0.9% krahasuar në baza mujore (t-1). Ndërkaq ndryshimi në baza vjetore i këtij indeksi ka pësuar një ndryshim pozitiv prej 2.6%. Periudha T4 2005 identifikohet me një ndryshim pozitiv të përqindjes së IÇK-së në baza vjetore, gjë që nuk ndodh në tremujorët paraprak të vitit 2005 dhe në të njëjtin tremujor në vitin të kaluar.




Kjo ngritje në IÇK kryesisht i atribuohet cigareve (+16.8%), transportit (+7.1%) dhe ushqimit (+4.2). Ndryshim negativ është regjistruar në çmimet e arsimit (-6.1%), pijeve alkoolike (-4.1%) dhe veshmbathjes (-3.4%).

### Papunësia e regjistruar

Sipas Zyrës për Punësim të Kosovës, numri i të papunëve të regjistruar është 318 mijë apo 2360 më shumë se në T3 2005. Kështu, numri i të papunëve të regjistruar është më i lartë për 5.3% krahasuar me T4 2004. Nuk ka ndryshim sa i përket strukturës gjinore të punëkërkuësve. 46% nga gjithsej numri punëkërkuësve janë femra. E njëjta qëndron edhe për kualifikimin arsimor të punëkërkuësve. Në veçanti, punëkërkuësit me shkollim fillor përbëjnë pjesën më të madhe (63.5%), të përcjellë nga punëkërkuësit me shkollim të mesëm (35%) dhe ata me fakultet që përbëjnë vetëm 1.5% të të gjithë punëkërkuësve të regjistruar.

### Privatizimi

Në tremujorin e katërt të vitit 2005 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ka shpallur 4 valë të reja të privatizimit (vala 9, 10, 11 dhe 12), por rezultatet e tenderit janë shpallur vetëm për valën e 9-të. Shuma që pritet të mblidhet nga kjo valë është rreth 19.4 milion euro, përmes privatizimit të 13 kompanive (një me 'spinof' special).




Andaj, sipas rezultateve të tenderëve deri në fund të vitit 2005 rreth 158 kompani duhet të privatizohen (nga të cilat 8 përmes 'spinofit' special). Të ardhurat e përgjithshme pritet të arrijnë shumë më prej 176.2 milion euro.

### SEKTORI I JASHTËM


Edhe pse ka shënuar ngritje të vogël T4 krahasuar me T3 (+0.2 pp), proporcioni i eksportit ndaj importit qëndron në 4.0%. Megjithatë, ky proporcion ka rënë për 1.3 pp në raport me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Importi gjatë T4 2005 ka arritur shumë më prej 317.3 milion euro me eksportin i cili ka arritur gjithsej shumë më prej 14.5 milion euro.

Siç është paraqitur në grafikun 14, deri në dhjetor të vitit 2005 rreth 43.7% (517.8 milion euro) të mallrave të përgjithshme të importuara i korrespondohet produkteve minerale (+23.2% rritje); ushqimit të gatshëm, pijeve dhe cigareve (+3.8% rritje); makinerisë, pajisjeve elektrike dhe shtëpiake aplikimi (+13.8 rritje).



Sa i përket partnerëve tregtarë, Bashkimi Evropian (BE) ruan vendin e importuesit më të madh në Kosovë. Në fund të T4 2005, BE-ja përbënte 34.5% të importit, që është 0.9 pp më ulët krahasuar me dhjetorin e vitit 2004. Me shumë prej 129.4 milion euro, importi nga Gjermania mban vendin e parë (31.6%) të importit nga BE-ja. Importi nga Maqedonia mbetet kontribuuesi më i lartë i importit të tërësishëm me 18.5% pjesëmarrje. Kjo paraqet një ngritje prej 4.4 pp krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërkaq importi nga Serbia dhe Mali i Zi paraqesin rritjen më të lartë në baza vjetore (129.4%) duke arritur kështu 14.1% të importit të përgjithshëm. Një rritje tjetër (+62.4%) është regjistruar tek importi nga Kina (që përbënë 4.7% të importit të përgjithshëm).


Grafiku 14. Importi sipas grupit të mallrave



përkatësisht 5.2 milion euro (në baza kumulative). Shikuar në baza vjetore, eksporti drejt Shqipërisë tregoi një rritje të konsiderueshme prej 190.5%, duke kontribuar kështu me 6.0% në rritjen e përgjithshme të eksporteve.

Krahasuar me fundin e tremujorit të tretë, në T4 2005 eksporti i përgjithshëm nuk paraqet ndonjë ndryshim të veçantë sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes së mallrave specifike të eksportuara. Përbërës kryesor i eksportit kosovar mbeten metalet bazë që përfshijnë 49.6% të eksportit, apo vetëm 0.4 pp më ulët se sa në T3 2005 (14.6 pp më lartë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Gëzofi, lëkurat dhe të ngjashme kanë arritur 12.6% të eksportit, e që është vetëm 0.1 pp më ulët se në fund të Q3 2005. Ushqimi i gatshëm, pijet dhe cigaret me shumën prej 4.1 milion euro përbënin 8.7% të eksportit të përgjithshëm.

Grafiku 15. Eksporti sipas grupit të mallrave



Me shumën prej 17.0 milion euro, eksporti në vendet e BE-së mban përqindjen më të lartë të eksportit të përgjithshëm të Kosovës. Vendet fqinje, Maqedonia dhe Shqipëria, mbulojnë rreth 31.7% të eksportit me një shumë prej 9.9



Tabela 1.

**Tregues të zgjedhur makroekonomik**

Përshkrimi	2001	2002	2003	2004	2005 *
<b>Normat reale të rritjes (në përqindje)</b>					
Produkti i brendshëm bruto	...	-2.9	-1.4	3.7	-0.5
Kontributi i ndihmës së jashtme në rritjen e PBB-s		-7.1	-7.6	-3.1	-1.5
Të ardhurat kombëtare të disponueshme bruto	...	0.3	2.5	4.6	1.1
Të ardhurat e disponueshme të sektorit privat	...	-4.6	0.9	5.3	1.6
Konsumi i sektorit privat	...	-1.7	1.6	6.3	3.4
Konsumi si pjesëmarrje në ardhurave të disponueshme	...	84.6	85.5	85.8	87.1
Importet komerciale	...	-9.0	-3.3	5.6	2.7
PBB për banorë	...	-4.5	-3.0	1.9	-2.2
Të ardhurat komb. të disponueshme bruto për banorë	...	-1.4	0.8	2.9	-0.6
Të ardhurat e disponueshme të sektorit privat për banorë	...	-6.2	-0.8	3.6	-0.1
Konsumi privat për banorë	...	-3.4	-0.1	4.6	1.7
<b>Ndryshimet e çmimeve (në përqindje)</b>					
Indeksi i çmimit të konsumit	11.7	3.6	1.1	0.0	-1.5
PBB	22.1	3.3	0.3	-0.2	-1.5
Norma reale efektive e këmbimit (bazuar në PBB)	8.6	0.9	-0.9	-1.9	0.0
<b>Buxheti i Qeverisë</b>					
Të hyrat	13.2	20.4	24.4	24.0	24.8
Shpenzimet	9.8	16.4	22.4	29.9	29.0
Prej të cilave: Kapitali	0.3	0.6	1.5	6.7	6.0
Bilanci aktual (rrjedhës)	3.6	4.6	3.4	0.9	1.8
Bilanci i përgjithshëm	3.4	4.0	1.9	-5.9	-4.2
Bilanci i përgjithshëm (pas granteve)	5.0	4.4	1.9	-5.3	-3.9
<b>Bilanci i kursimeve dhe investimeve (si përqindje e PBB-s) 1/</b>					
Kursimet vendore	-9.9	-7.2	-7.5	-8.2	-8.4
Remitancat	13.0	14.0	14.1	13.6	14.1
Të hyrat nga jashtë	-21.3	-18.1	-14.1	-11.9	-10.3
Kursimet kombëtare	-18.2	-11.3	-7.4	-6.5	-4.7
Investimet	27.1	24.7	23.6	23.7	24.4
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	-45.2	-36.0	-31.1	-30.2	-29.1
Ndihma e jashtme 2/	47.5	36.3	28.4	22.7	21.2
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (pas granteve të jashtme)	2.3	0.3	-2.6	-7.5	-7.9
<b>Agreatët kryesorë (në miliona Euro)</b>					
PBB	2,439	2,447	2,420	2,505	2,453
PBB për banorë (në Euro)	1,306	1,288	1,252	1,274	1,227
Të ardhurat kombëtare të disponueshme bruto (në Euro)	1,198	1,235	1,253	1,297	1,273
Remitanat 3/	317	341	341	341	345
Ndihma e jashtme 2/	1,159	887	688	568	519
Kontributi i drejtpërdrejtë i ndihmës së jashtme në PBB	589	484	393	330	327
Kontributi i drejtpërdrejtë i ndihmës së jashtme në TKDB	648	503	398	334	327
Banorët (në mijëra)	1,868	1,900	1,932	1,965	1,999

Burimi: Vlerësimet e stafit të FMN-s (Korrik 2005).

1/ Bilanci i investimeve dhe kursimeve të ekonomisë, sektori vendor dhe donatorët;

2/ Gjithsej ndihma e jashtme duke përjashtuar transferet kapitale;

3/ Duke përfshirë pensionet nga jashtë;

\* E parashikuar.



## 2. ZHVILLIMET AKTUALE (grafikët) ----- 17

### 2.1. Sektori financiar ----- 19

- Agregatët monetarë -----19
- Kërkesat e korporatave financiare sipas sektorëve ----- 19
- Mjetet e huaja neto dhe kërkesat e brendshme të korporatave depozituese ----- 19
- Rritja e depozitave të klientëve në korporatat depozituese dhe kontributet në këtë rritje ----- 20
- Klasifikimi sektoral i depozitëve në BPK -----20
- Kërkesat e jashtme dhe të brendshme të KTD, si përqindje e gjithsej mjeteve - ----- 20
- Klasifikimi sektoral i depozitëve në korporatat tjera depozituese ----- 21
- Klasifikimi sipas maturimit i depozitëve në korporatat tjera depozituese ----- 21
- Klasifikimi sipas valutave i depozitëve në korporatat tjera depozituese ----- 21
- Klasifikimi sektoral i kredive të korporatave tjera depozituese ----- 22
- Klasifikimi sipas maturitetit i kredive të korporatave tjera depozituese ----- 22
- Raporti i kredive me depozitë i korporatave tjera depozituese ----- 23
- Të hyrat dhe të dalat e korporatave tjera depozituese ----- 23
- Transfertat e huaja ----- 23
- Premiumet dhe kërkesat e paguara të kompanive të sigurimeve ----- 23

### 2.2. Sektori fiskal ----- 24

- Operacionet e Qeverisë ----- 24
- Struktura e të hyrave të Qeverisë -----24
- Struktura e shpenzimeve të Qeverisë ----- 24

### 2.3. Sektori real ----- 25

- Indeksi i çmimit të konsumit ----- 25


### 2.4. Sektori i jashtëm----- 25

- Norma e këmbimit kundrejt valutës Euros ----- 25
- Bilanci tregtar ----- 25



## 1. Agregatët monetarë

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 4.

## 2. Kërkesat e korporatave financiare sipas sektorëve


(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 2.

## 3. Mjete e huaja neto dhe kërkesat e brendshme të korporatave depozituese


(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 3.


#### 4. Rritja e depozitave të klientëve në korporatat depozituese dhe kontributet në këtë rritje

(Ndryshimi mujor në përqindje)




#### 5. Klasifikimi sektoral i depozitëve në BPK

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)




#### 6. Kërkesat e jashtme dhe të brendshme të korporatave tjera depozituese, si përqindje e gjithsej mjeteve

(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



## 7. Klasikimi sektorial i depozitëve në korporatat tjera depozituese


(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 14.

## 8. Klasifikimi sipas maturimit i depozitëve në korporatat tjera depozituese


(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 15 dhe 16.

## 9. Klasifikimi sipas valutave i depozitëve në korporatat tjera depozituese


(Të dhënat kumulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 15 dhe 16.

## 10. Klasifikimi sektoral i kredive të korporatave depozituese


(Të dhënat komulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 17.

## 11. Klasifikimi sipas maturitetit i kredive të korporatave tjera depozituese


(Të dhënat komulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 17.

## 12. Raporti kredive me depozitë i korporatave tjera depozituese

(Të dhënat komulative, fundi i periudhës, në miliona EUR)




Burimi: Tabela 13 dhe 14.



### 13. Të hyrat dhe të dalat e korporatave tjera deponuese


(Kumulative brenda vitit kalendarik, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 20.

### 14. Transfertat e huaja


(Kumulative brenda vitit kalendarik, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 22.

### 15. Premiumet dhe kërkesat e paguara të kompanive të sigurimeve


(Kumulative brenda vitit kalendarik, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 23.

## 16. Operacionet e Qeverisë


(Kumulative brenda vitit kalendarik, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 27.

## 17. Struktura e të hyrave të Qeverisë


(Në përqindje)



Burimi: Tabela 27.

## 18. Struktura e shpenzimeve të Qeverisë


(Në përqindje)



Burimi: Tabela 27.

## 19. Indeksi i çmimit të konsumit


(Në përqindje)



Burimi: Tabela 28.

## 20. Normat e këmbimit kundrejt valutës Euro


(Mesatarja e periudhës)



Burimi: Tabela 30.

## 21. Bilanci tregtar

(Kumulative brenda vitit kalendarik, në miliona EUR)



Burimi: Tabela 31.



### 3. TABELA STATISTIKORE -----27

#### 3.1. Sektori financiar ----- 29

- Pasqyrë e korporatave financiare ----- 29
- Pasqyrë e korporatave depozituese ----- 30
- Agregatët monetarë ----- 31
- Pasqyra e BPK-s ----- 32
- Pasqyrë e korporatave të tjera depozituese ----- 34
- Pasqyrë e korporatave të tjera financiare ----- 34
- Pasqyrë e ndërmjetësuesve të tjerë financiarë ----- 35
- Pasqyrë e kompanive të sigurimeve dhe fondeve pensionale ----- 35
- Pasqyrë e kompanive të sigurimeve ----- 36
- Pasqyrë e fondeve pensionale ----- 36
- Bilanci i gjendjes së BPK-s ----- 37
- Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese ----- 38
- Euro depozitat në KTD-t, sipas maturitetit fillestar ----- 40
- Jo-Euro depozitat në KTD-t, sipas maturitetit fillesatar ----- 41
- Kreditë e KTD-ve, sipas maturitetit fillestar ----- 42
- Kreditë e KTD-ve, sipas industrisë ----- 42
- Normat efektive të interesit të KTD-ve ----- 43
- Pasqyra e të ardhurave të KTD-ve ----- 44
- Sistemi ndërbankar i pagesave të BPK-s ----- 45
- Transferat e huaja ----- 45
- Aktiviteti i kompanive të sigurimeve ----- 45
- Aktiviteti kreditor i ndërmjetësuesve të tjerë financiarë ----- 46
- Korporatat financiare – shpërndarja gjeografike ----- 46
- Korporatat depozituese – numri i punonjësve dhe degëve ----- 47

#### 3.2. Sektori fiskal ----- 48

- Operacionet e qeverisë ----- 48

#### 3.3. Sektori real ----- 49

- Indeksi i çmimit të konsumit ----- 49
- Papunësia e regjistruar ----- 49

#### 3.4. Sektori i jashtëm ----- 50

- Norma e këmbimit kundrejt valutës Euro ----- 50
- Eksporti dhe importi, sipas partnerëve tregtarë ----- 51
- Eksporti, sipas grupit të mallrave ----- 52
- Importi, sipas grupit të mallrave ----- 52



Tabela 2.

**Pasqyrë e korporatave financiare**

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në mijëra EUR)

Përshkrimi	2004			2005			
	Qer	Shta	Dhje	Mar	Qer	Shta	Dhje
<b>Mjetet e huaja neto</b>	<b>692,727</b>	<b>712,727</b>	<b>639,230</b>	<b>657,840</b>	<b>638,543</b>	<b>664,553</b>	<b>662,482</b>
<b>Kërkesat ndaj jo-rezidentëve</b>	<b>720,320</b>	<b>750,189</b>	<b>691,217</b>	<b>713,870</b>	<b>701,094</b>	<b>749,675</b>	<b>749,755</b>
Valuta	87,295	74,517	56,231	102,918	90,285	99,673	76,675
Depozita	508,346	522,539	383,820	387,261	342,921	374,830	422,616
Letrat me vlerë krahas aksioneve	115,713	141,520	236,198	217,136	261,047	268,863	242,434
Kreditë	6,115	8,298	11,652	3,240	3,462	2,994	4,715
Kapitali aksionar dhe të tjera	2,850	3,313	3,313	3,313	3,313	3,313	3,313
Të tjera	2	2	2	2	67	2	2
<b>minus: Detyrime ndaj jo-rezidentëve</b>	<b>27,593</b>	<b>37,463</b>	<b>51,987</b>	<b>56,030</b>	<b>62,550</b>	<b>85,121</b>	<b>87,273</b>
Depozita	3,273	8,840	17,862	21,188	21,297	23,410	21,457
Kapitali aksionar	23,989	28,623	34,125	34,842	41,253	61,712	65,817
Të tjera	331	...	...	...	...	...	...
<b>Kërkesat e brendshme</b>	<b>26,095</b>	<b>69,262</b>	<b>205,603</b>	<b>211,426</b>	<b>278,293</b>	<b>281,627</b>	<b>351,879</b>
<b>Kërkesat neto ndaj qeverisë qendrore</b>	<b>-331,383</b>	<b>-326,020</b>	<b>-212,398</b>	<b>-252,272</b>	<b>-246,138</b>	<b>-256,007</b>	<b>-220,706</b>
<b>Kërkesat ndaj qeverisë qendrore</b>	<b>—</b>	<b>—</b>	<b>—</b>	<b>—</b>	<b>—</b>	<b>—</b>	<b>—</b>
<b>minus: Detyrimet ndaj qeverisë qendrore</b>	<b>331,383</b>	<b>326,020</b>	<b>212,398</b>	<b>252,272</b>	<b>246,138</b>	<b>256,007</b>	<b>220,706</b>
Depozita	331,383	326,020	212,398	252,272	246,138	256,007	220,706
<b>Kërkesat ndaj sektorëve të tjerë</b>	<b>357,478</b>	<b>395,283</b>	<b>418,001</b>	<b>463,698</b>	<b>524,431</b>	<b>537,634</b>	<b>572,586</b>
<b>Kreditë</b>	<b>350,061</b>	<b>387,836</b>	<b>413,524</b>	<b>456,017</b>	<b>516,244</b>	<b>528,749</b>	<b>565,499</b>
Korporata të tjera jo-financiare	285,327	311,210	329,811	367,067	404,520	405,869	439,513
Sektorë të tjerë rezidentë	64,734	76,626	83,714	88,950	111,725	122,880	125,986
Ekonomi familjare	64,734	76,626	83,714	88,950	111,725	122,880	125,986
<b>Kërkesa të tjera</b>	<b>7,417</b>	<b>7,447</b>	<b>4,476</b>	<b>7,681</b>	<b>8,187</b>	<b>8,885</b>	<b>7,087</b>
<b>Depozitat</b>	<b>577,938</b>	<b>625,344</b>	<b>675,512</b>	<b>688,730</b>	<b>720,114</b>	<b>751,071</b>	<b>812,824</b>
<b>Depozita të transferueshme</b>	<b>295,522</b>	<b>297,290</b>	<b>276,057</b>	<b>288,288</b>	<b>305,722</b>	<b>306,020</b>	<b>318,151</b>
Qeveria lokale	3,066	4,441	3,212	6,409	4,351	4,884	4,464
Fondi i sigurimit shoqëror	1,549	113	2,968	506	5,535	658	1,708
Korporata publike jo-financiare	57,351	59,411	28,932	56,271	58,446	62,242	66,407
Korporata të tjera jo-financiare	90,351	59,786	86,052	68,110	67,145	70,712	77,644
Sektorë të tjerë rezidentë	143,206	173,539	154,893	156,992	170,247	167,524	167,928
prej të cilave: Ekonomi familjare	128,130	157,702	144,149	146,802	158,920	155,495	155,053
prej të cilave: OJSHEF	13,548	14,201	9,069	8,363	9,341	9,955	10,686
<b>Depozita të tjera</b>	<b>282,415</b>	<b>328,054</b>	<b>399,455</b>	<b>400,442</b>	<b>414,392</b>	<b>445,051</b>	<b>494,673</b>
Korporata publike jo-financiare	83,618	94,938	133,069	115,002	120,264	95,080	86,292
Korporata të tjera jo-financiare	24,318	34,791	41,621	40,998	45,033	81,057	107,880
Sektorë të tjerë rezidentë	174,480	198,325	224,765	244,441	249,095	268,914	300,501
Ekonomi familjare	174,455	198,292	224,056	244,218	249,043	268,813	298,884
OJSHEF	25	34	709	224	52	52	52
<b>Kreditë</b>	<b>5,778</b>	<b>5,947</b>	<b>2,330</b>	<b>2,434</b>	<b>2,923</b>	<b>3,031</b>	<b>3,022</b>
Korporata të tjera jo-financiare	1,461	1,496	...	...	...	...	...
Ekonomi familjare	4,318	4,451	2,330	2,434	2,923	3,031	3,022
<b>Rezerva teknike të sigurimit</b>	<b>21,487</b>	<b>25,419</b>	<b>23,605</b>	<b>28,589</b>	<b>30,305</b>	<b>31,196</b>	<b>30,816</b>
Kapitali neto i ekonomive familjare në rezervat e sigurimit të jetës	—	—	—	—	—	—	—
Kapitali neto i ekonomive familjare në fondet pensionale	4,274	5,005	5,755	6,832	7,583	8,469	8,725
Para-pagimi i premiumeve dhe rezervat kundrejt kërkesave kumulative	17,213	20,414	17,850	21,757	22,722	22,726	22,091
<b>Kapitali aksionar dhe të tjera</b>	<b>123,938</b>	<b>132,898</b>	<b>141,173</b>	<b>141,401</b>	<b>147,477</b>	<b>154,358</b>	<b>160,891</b>
Fondet kontribuar nga zotëruesit	69,228	78,995	88,290	82,630	80,830	85,710	90,143
Fitimet e mbajtura	8,331	12,804	11,326	18,533	23,830	18,504	14,683
Rezervat e përgjithshme dhe të veçanta	22,172	14,381	10,266	14,510	14,057	14,097	14,079
Fitimi/humbja e vitit	5,268	8,088	11,710	5,348	3,889	10,339	16,396
Grantet nga donatorët	18,938	18,629	19,581	20,381	24,871	25,708	25,590
<b>Zëra të tjerë (neto)</b>	<b>-10,318</b>	<b>-7,618</b>	<b>2,212</b>	<b>8,112</b>	<b>16,016</b>	<b>6,524</b>	<b>6,808</b>
Detyrime të tjera	30,675	30,356	36,550	40,096	52,176	42,831	44,390
minus: Mjete të tjera	40,927	37,163	35,157	34,692	39,360	39,741	41,385
plus: Përshtatja e konsolidimit	-66	-812	819	2,708	3,200	3,434	3,803





Tabela 4.

**Agregatët monetarë**

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në mijëra EUR)

Përshkrimi	2003	2004	2005											
	Dhje	Dhje	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Baza monetare	588,611	477,663	463,006	464,840	460,003	466,207	452,638	448,210	451,508	420,605	411,972	427,541	417,315	379,503
Valuta jashtë KD-ve (e)	529,000	404,764	408,810	407,512	399,112	401,075	384,646	372,442	379,444	353,330	346,039	358,695	346,926	296,985
Rezervat e KTD-ve	59,612	72,899	54,196	57,328	60,891	65,131	67,993	75,768	72,065	67,275	65,933	68,846	70,389	82,518
<b>Agregati monetar M1</b>	<b>832,721</b>	<b>710,385</b>	<b>723,708</b>	<b>713,674</b>	<b>721,078</b>	<b>706,135</b>	<b>705,563</b>	<b>712,990</b>	<b>677,564</b>	<b>687,426</b>	<b>679,899</b>	<b>676,603</b>	<b>664,057</b>	<b>646,747</b>
Valuta jashtë KD-ve	529,000	404,764	408,810	407,512	399,112	401,075	384,646	372,442	379,444	353,330	346,039	358,695	346,926	296,985
Depozita të transferueshme	303,721	305,621	314,898	306,163	321,966	305,060	320,918	340,548	298,120	334,096	333,860	317,908	317,131	349,761
Korporata të tjera financiare	.	29,564	32,407	32,571	33,678	35,159	40,526	34,825	32,955	30,953	27,840	31,101	31,917	31,610
Qeveria lokale	.	3,212	4,480	3,980	6,409	5,027	4,725	4,351	3,763	4,405	4,884	4,739	4,052	4,464
Fondi i sigurimit shoqëror	.	2,968	5,869	228	506	1,588	1,580	5,535	3,724	4,313	658	5,512	452	1,708
Korp. publike jo-financiare	5,288	28,932	45,300	43,783	56,271	41,558	47,997	58,446	29,194	49,076	62,242	50,824	49,352	66,407
Korp. të tjera jo-financiare 1/	155,139	86,052	76,971	72,025	68,110	58,883	63,245	67,145	68,255	84,965	70,712	67,725	68,843	77,644
Sektorë të tjerë rezidentë	143,294	154,893	149,871	153,576	156,992	162,845	162,843	170,247	160,231	160,384	167,524	158,007	162,515	167,928
prej të cilave: Ek. familj. 2/	143,294	144,149	139,417	142,890	146,802	152,952	152,851	158,920	148,606	149,165	155,495	146,220	145,917	155,053
prej të cilave: OJSHEF	.	9,069	8,757	8,947	8,363	8,022	8,062	9,341	9,634	9,166	9,955	9,655	14,429	10,686
<b>Agregati monetar M2</b>	<b>1,030,185</b>	<b>1,124,962</b>	<b>1,128,431</b>	<b>1,131,899</b>	<b>1,135,368</b>	<b>1,138,837</b>	<b>1,142,305</b>	<b>1,145,774</b>	<b>1,149,242</b>	<b>1,152,711</b>	<b>1,156,180</b>	<b>1,159,648</b>	<b>1,163,117</b>	<b>1,166,586</b>
Agregati monetar M1	832,721	710,385	723,708	713,674	721,078	706,135	705,563	712,990	677,564	687,426	679,899	676,603	664,057	646,747
Depozita të tjera 3/	197,464	414,577	404,723	418,225	414,290	432,701	436,742	432,784	471,679	465,285	476,281	483,045	499,060	519,839
Korporata të tjera financiare	.	19,109	16,791	17,521	18,732	17,990	18,023	23,079	24,393	25,245	45,310	45,230	43,779	45,140
Korp. publike jo-financiare	.	133,069	117,975	123,000	115,002	129,044	127,544	120,264	122,938	130,049	95,080	76,830	83,470	86,292
Korp. të tjera jo-financiare 1/	74,758	39,510	35,287	40,394	38,892	43,400	44,317	43,892	76,252	52,955	80,258	101,212	105,066	107,201
Sektorë të tjerë rezidentë	122,706	222,889	234,670	237,310	241,663	242,267	246,858	245,549	248,095	257,035	255,633	259,774	266,745	281,206
Ekonomi familjare 2/	122,706	222,180	233,961	236,595	241,440	242,213	246,802	245,497	248,044	256,981	255,531	259,671	266,646	279,590
OJSHEF	.	709	709	715	224	55	56	52	51	54	101	103	100	1,616

1/ Deri në maj 2004 të dhënat për të gjitha korporatat jo-financiare;

2/ Deri në maj 2004 të dhënat për ekonominë familjare përfshijnë OJSHEF-t;

3/ Depozita me maturitetet fillestar deri në 2 vite.

Tabela 5.

**Pasqyra e BPK-s**

(Të dhëna kumulative, fundi i periudhës, në mijëra EUR)

Përshkrimi	2003	2004	2005											
	Dhje	Dhje	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
Mjetet e huaja neto	453,691	344,505	370,602	366,556	374,833	381,701	376,007	390,085	394,347	407,985	389,070	431,904	433,053	394,293
Kërkesat ndaj jo-rezidentëve	453,990	349,684	375,470	369,815	377,329	383,856	378,670	391,924	395,347	414,580	395,330	437,152	437,276	397,399
Valuta	26,590	12,064	39,298	34,943	42,051	23,039	39,815	38,268	33,371	30,120	45,206	32,157	47,314	24,464
Depozita	427,399	213,202	201,675	195,384	196,052	211,516	189,601	204,330	202,592	215,077	190,679	245,566	230,481	213,448
Let. me vlerë krahas aksioneve	—	124,418	134,497	139,487	139,225	149,301	149,254	149,325	159,384	169,383	159,444	159,429	159,481	159,488
minus: Detyrimet ndaj jo-rezidentëve	298	5,179	4,867	3,259	2,496	2,155	2,663	1,839	1,000	6,595	6,260	5,248	4,223	3,106
Depozita	298	5,179	4,867	3,259	2,496	2,155	2,663	1,839	1,000	6,595	6,260	5,248	4,223	3,106
Kërkesat neto ndaj qeverisë qëndrore	-342,740	-212,398	-253,620	-252,716	-252,262	-252,229	-242,386	-246,136	-257,802	-264,073	-256,003	-297,295	-302,004	-220,678
Kërkesat ndaj qeverisë qëndrore	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—
minus: Det. ndaj qeverisë qëndrore	342,740	212,398	253,620	252,716	252,262	252,229	242,386	246,136	257,802	264,073	256,003	297,295	302,004	220,678
Depozita	342,740	212,398	253,620	252,716	252,262	252,229	242,386	246,136	257,802	264,073	256,003	297,295	302,004	220,678
Kërkesat ndaj sektorëve të tjerë	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—
Baza monetare	64,917	115,011	99,480	96,109	104,985	111,444	115,742	125,926	118,355	125,512	114,340	115,690	111,886	154,118
Detyrimet ndaj KTD-ve	59,612	72,899	54,196	57,328	60,891	65,131	67,993	75,768	72,065	67,275	65,933	68,846	70,389	82,518
Depozita të transferueshme	59,612	72,899	54,196	57,328	60,891	65,131	67,993	75,768	72,065	67,275	65,933	68,846	70,389	82,518
prej të cilave: Dep. rezervë	31,329	45,442	43,789	45,626	46,447	47,233	46,439	49,979	49,632	48,059	52,079	53,826	55,901	58,794
Dep. të përfshira në paranë e gjerë*	5,305	42,112	45,284	38,781	44,095	46,312	47,750	50,158	46,290	58,237	48,407	46,844	41,498	71,600
Depozita të transferueshme	5,305	37,012	42,334	35,831	41,145	43,362	44,800	44,707	39,685	51,628	42,807	42,744	37,398	67,500
Korp. të tjera financiare	—	20,527	23,114	23,388	26,230	25,756	25,639	22,842	22,083	21,566	21,635	23,150	23,094	24,409
Qeveria lokale	—	1,891	1,892	1,894	1,895	1,897	1,898	1,900	1,901	1,903	1,602	1,600	1,601	1,602
Fondi i sigurimit shoqëror	—	2,968	5,869	228	506	1,588	1,580	5,535	3,724	4,313	658	5,512	452	1,708
Korp. publike jo-financiare	5,288	9,942	9,747	8,572	10,677	12,243	13,743	12,436	9,981	21,789	16,833	10,348	10,080	37,587
Korp. e tjera jo-financiare	17	10	15	10	8	8	8	8	5	4	4	3	3	5
Sektorë të tjerë rezidentë	—	1,675	1,697	1,739	1,828	1,871	1,931	1,986	1,992	2,054	2,074	2,131	2,168	2,188
Depozita të tjera	—	5,100	2,950	2,950	2,950	2,950	2,950	5,451	6,605	6,609	5,600	4,100	4,100	4,100
Korp. të tjera financiare	—	5,100	2,950	2,950	2,950	2,950	2,950	5,451	6,605	6,609	5,600	4,100	4,100	4,100
Depozita jashtë parasë së gjerë	31,007	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—
Korp. të tjera financiare	26,238	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—
